

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	3.1.2024	Informacion në lidhje me projektin “Opera on Tour”	12.1.2024	1. Buxheti total i projektit “Opera on tour” mbuluar nga Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor është 1,515,665 lekë. Bëjmë me dije se lloji i nismës të ndërmarrë nga TKOBAP është “opera on tour” por titulli është “Skena vjen tek Ju”. 2. Vlera totale e shpenzimit të karburantit është 137,165 lekë për lëvizjen e trupës, skenës, fonisë, etj. 3. Kosto financiare nga pushteti lokal, bashkitë	Përfunduar. Kthim përgjigje me shresë.	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				e qyteteve ku janë dhënë koncert është 0 zero. 4. Artistët pjesëmarrës në këtë tour janë staf i TKOBAP me një experiencë disavjeçare. 5. Komoditeti i artistëve në temperaturat e ftohta është pjesë e punës sonë e cila duke zgjatur vetem 60-70 minuta është e përballueshme. Në vendet të cilat është i papërballueshëm i ftohti si në Kukës, koncerti është zhvilluar në Pallatin e Kulturës. 6. Aktualisht TKOBAP nuk ka projekte të ngjashme por është e hapur për çdo kërkesë bashkëpunimi që do të ketë në vijimësi. 7. Orkestrat simfonike të qyteteve administrohen nga Njesitë e vetëqeverisjes vendore, institucione të cilat çdo vit parashikojnë buxhet për aktivitete kulturore.	
--	--	--	--	--	--

				Ministria e Kulturës bashkëpunon por nuk jep fonde publike për keto orkestra. Aktivitetet në rrethe në kuadër të gjallërimit të jetës artistike dhe kulturore kanë qenë të shumta, ku përmendim: Turin veror, projektet me Thirrje në Art, kulture dhe trashëgimi, nga të cilat janë mbështetur shoqata e individë për aktivitete me shtrirje të gjerë territorial. Përmendim gjithashtu Javët Kulturore Ndërkombëtare, ku ka pasur aktivitete të shumta me pjesëmarrjen e artistëve, orkestrave e grupeve ndërkombëtare, nga veriu në jug të vendit përgjatë gjithë vitit.		
2	8.1.2024	Informacion per Shtepine e Abat Preng Doçit e shpallur Monument Kulture e	10.1.2024	Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 119/2014 "Per Te Drejten e Informimit", si dhe Ligjit Nr.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		kategorise 2 me date 08.01.2015. Ju lutem me dergoni informacion te pergjithshem mbi gjendjen fizike te objektit dhe mbi Juridiksjonin e godines,pra informacion se kush eshte "pronari" i nderteses dhe se kush e ka per detyrim ta mirembaje.		27/2018 "Per trashegimine Kulturore dhe Muzete", Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore, nga verifikimi i dokumentacionit arkivor në Arkivin Teknik për banesën "Ish banesa e Abat Docit dhe Tefe Curanit", Bashkia Shkodër, nuk disponon dosje teknike, por vetëm aktin e deklarimit pasuri kulturore të kësaj banese. Gjithashtu ju informojme se nuk eshte kompetence e Ministrise se Kultures dhenia e informacionit mbi juridiksionin e prones. Sa më sipër, ju vendosim në dsipozicion Urdhrin Nr. 527, datë 13.08.2018 të Ministrit të Kulturës.	
--	--	--	--	---	--

3	6.1.2024	Udhëzim se si mund të aplikojmë për të shpallur vallen e 'Osman Takës' si një “Kryevlerë Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”.	11.1.2024	Bashkelidhur po ju dërgojmë linkun për procedurën e aplikimit për Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. https://regjistrickj.al/procedura-e-aplikimit-per-inventarin-kombetar-te-trashegimise-kulturore-jomateriale/ Njëkohësisht duhet pasur parasysh se, sipas "Konventes per Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale", UNESCO 2003, neni 11: "I përket çdo shteti palë: a) të marrë masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij; b) të ndërmarrë masat e ruajtjes... për të identifikuar dhe	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.
---	----------	---	-----------	--	--	---------

				<i>përcaktuar elementet e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij, me pjesëmarrjen e bashkësive, të grupeve dhe të organizatave joqeveritare përkatëse."</i>		
4	29.12.2023	Xhamia e Plumbit Shkoder, kerkohet per arsye kerkimi shkencor, artikuj ne revista apo/ edhe konferenca material si: relacion teknik, pershkrim historik, si dhe dokumentacion arkitektonik si planimetri, pamje, prerje; si dhe foto nese ka.	10.1.2024	Kerkuesit I eshte vendosur ne dispozicion bashkëlidhur ne link materialin arkivor te viteve '70 -te shek XX lidhur me kete pasuri kulturore si me poshtë: -Dokumentacion arkitektonik (plan, pamje, prerje) -Relacion pershkrimor, viti 1986.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.
5	9.1.2024	Kerkese per informacion mbi punesimin e klarinetistit e TKOBAB z. E.N	30.1.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkrese.	Nuk ka.

6	16.1.2024	Kerkese per informacion mbi konsultimin publik, pjesemarrjen e OJF-ve ne grupe pune,...	30.1.2024	1.Gjatë vitit 2023, Ministria përgjegjëse për kulturën ka realizuar procesin e konsultimit publik për 1 (një) projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar duke përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. 2.Procesi i konsultimit është kryer nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe zhvillimi i takimeve publike. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.
---	-----------	---	-----------	--	--	---------

				i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik me përfshirjen e aktorëve dhe grupeve të interesit të fushës. 3.Nëpërmjet Regjistrat Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik nuk kanë ardhur komente, qoftë edhe nga OJF. 4.Në procesin e konsultimit publik realizuar nëpërmjet një takimi publik kanë marrë pjesë edhe shoqata si Shoqata e Botuesve dhe Shoqata e Përkthyesve. 5.Kordinatori për konsultimin publik për ministrinë përgjegjëse për kulturën është znj... 6.Sa i përket pyetjes suaj nëse institucioni ka koordinator për shoqërinë civile, bëjmë me dije se Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka	
--	--	--	--	---	--

				koordinator për shoqërinë civile. 7.Në ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është parashikuar ngritja e organeve këshillimore dhe në zbatim të ligjit është miratuar udhëzimi nr. 666 datë 23.10.2023 “Për mënyrën e funksionimit të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasurite e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale” ku është parashikuar ngritja e organeve këshillimore të cilat nuk parashikojnë në përbërjen e tyre anëtarë nga OJF (neni 59 i ligjit 27/2018). 8.Pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit funksionon Këshilli Kombëtar për të		
--	--	--	--	---	--	--

				Drejtën e Autorit (KKDA), i cili përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Mënyra e funksionimit, shpërblimit dhe e organizimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për sa i përket funksionimit të Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), propozime për zgjedhjen e anëtarëve të KKDA-së mund të bëjnë agjencitë e administrimit kolektiv dhe shoqatat përfaqësuese të përdoruesve, si dhe çdo subjekt i interesuar. Në këtë rast, çdo agjenci e administrimit kolektiv e licencuar nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit duhet të regjistrohet si organizatë jofitimprurëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. 9.Në zbatim të nenit 133, të ligjit nr. 35,		
--	--	--	--	--	--	--

				datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, administrimi kolektiv i të drejtave kryhet nga agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave, si subjekt juridik, i krijuar nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura. Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë është e vlefshme për një afat 3 (tre) vjeçar, si dhe mund të jetë e rinovueshme.		
7	23.1.2024	Si ka vijuar puna për restaurimin e tre objekteve të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, konkretisht: Ndërtesa e Muzeut Etnografik të Krujës financuar falë programit EU4CULTURE, Kullës së Sahatit dhe Teqesë së Dollmës.	19.2.2024	Ne lidhje me ecurinë e punimeve të "Muzeut Etnografik" në Krujë, shpallur Monument Kulture i kategorisë së I-re, fillimisht nga Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës me vendim nr. 6, dt. 15.01.1963 dhe më pas nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

				Vendim Nr.1886, dt.10.06.1973, ju bejme me dije se: Referuar raportit te supervizimit, Punimet restauruese, civile, elektrike dhe mekanike kanë përfunduar në masën 100%. Punimet për multimedian dhe muzealizimin kanë përfunduar në masën 98 %. Multimedia pritet të përfundojë me të gjitha testimet_fund Shkurti 2024. Kulla e Sahatit, Krujë - Projekti “Ndërrhyrje Emergjente përforcuese në Kullën e Sahatit, Krujë”, miratuar me Vendim Nr. 8, datë 15.01.2021. Punimet për fazën e emergjencës sipas projektit të sipërcituar kanë filluar me 31.03.2021 dhe kanë përfunduar 30.08.2021 ne perputhje me legjislacionin në fuqi. Projekti parashikonte stabilizimin e		
--	--	--	--	---	--	--

				përkohshëm të objektit. Me Vendim të KKTKM-së Nr.319, dt.01.07.2022 është miratuar Projekti "Ndërhyrje konservuese dhe përforcimi strukturor “Kulla e Sahatit” Krujë” Monument Kulture Kategoria e I-rë, me aplikues dhe zhvillues CHëB. Me Vendim të KKTKM-së Nr.9, dt.15.01.2021 është miratuar Projekti "Ndërhyrje emergjente përforcuese në Teqenë e Dollmes, Krujë", me aplikues CHëB. Punimet kanë nisur me datë 22.02.2021 me një grafik punimesh prej 12 muajsh. Me Vendim të KKTKM-së Nr.74, dt.08.04.2022 është miratuar kërkesa e CHëB për shtyrjen e afatit të punimeve me 6 muaj, në projektin “Ndërhyrje		
--	--	--	--	---	--	--

				konservuese dhe përforcuese në Tegenë e Dollmës, Krujë”.		
8	22.1.2024	Informacion mbi projektin “Opera on Tour”	9.2.2024	Informacioni është venë në dispozicion.	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë.	Nuk ka.
9	30.1.2024	Informacion për fituesit e projekteve kulturore për vitet 2020, 2021, 2022, 2023.	8.2.2024	Informacioni është venë në dispozicion.	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë.	Nuk ka.
10	26.1.2024	Informacion në lidhje me restaurimin e Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura.	19.2.2024	Mes Ministrisë së Kulturës dhe Bashkimit të Operatoreve është lidhur kontrata nr. 3047 prot. datë 10.06.2021 për objektin "Restaurim, rikonstruksion dhe rehabilitim i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)", ndryshuar me Kontratë Shtesë me Nr.3047/2 prot., datë 8.7.2021, në të cilën janë saktësuar vlerat e likuidimit gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Vlera totale e kontratës është 884,070,327.8 leke pa t.v.sh dhe	Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë.	Nuk ka.

				1,060,884,393.36 leke me t.v.sh. Pas miratimit te projektit dhe preventivit te rishikuar nga Keshilli Kombetar i Trashegimise Kulturore Materiale (KKTKM) me vendimin nr. 513 date 06.10.2023, eshte hartuar dhe nenshkruar Modifikimi Kontrates (Kontrata Shtese) me nr. 6235 prot. date 07.12.2023. Vlera Totale e Kontrates se bashku me vleren e Shteses se kontrates bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimeve te rishikuar eshte 1,105,010,412.79 leke pa t.v.sh dhe 1,326,012,495.35 leke me t.v.sh. Gjithashtu, Modifikimi i Kontrates parashikon edhe shtyrjen e afatit te perfundimit te punimeve deri ne daten 18.10.2025.		
--	--	--	--	---	--	--

				Perfundimi i kontrates shtese eshte data 18.10.2025. Sipas konfirmimit me Drejtorine e Finances , vlera e paguar deri me tani nga kontrata baze dhe shtese eshte 370.341.060 leke. Sipas komunikimit me ndjekesin e kontrates, realizimi i punimeve eshte 28% (duke e llogaritur bashke me amendimin) i preventivit te ri. Punimet e realizuara jane kryesisht punimet e betonit dhe b/a ne masen 100% ne objektin e ri dhe 40% ne perforcimin e objektit ekzistues. Jane kryer punimet e germimit, pilotimit, ndertimit te themeleve, bodrumit, hidroizolimit te bodrumit ne masen 100% ne objektin e ri. Po punohet aktualisht me perforcimin e kallonave te objektit		
--	--	--	--	---	--	--

				ekzistues ne katin e pare dhe te dyte pasi themelet dhe kati perdhe jane te bere ne masen 90%. Gjithashtu fillojne punimet e konstruksionit metalik te pjeses se re qe ka katin e trete konsol metalik si dhe shkallet ne hollin e galerise dhe pasazhet lidhes te objekteve. Mbas ketyre fillon faza e ngritjes se fasades ,rifinitures ,dhe sistemit inxhinierik.		
11	7.2.2024	Informacion në lidhje me Gjithëpërfshirjen dhe Aksesueshmerine ne fushën e artit dhe kulturës në Shqipëri.	26.2.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.
12	7.2.2024	A ka një reagim nga Ministria e Kulturës lidhur me me shpalljen e Monumentit “Muret e Portës” në Durrës në programin “7 më të Rrezikuarit” në Europë , nga “Zëri European i Shoqërisë Civile të Përkushtuar ndaj	20.2.2024	Bazuar ne Ligjin nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete", institucionet e specializuara ne varesie te Ministrise se Kultures (sot Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit) qe prej	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore”, e njohur si Europa Nostra, në bashkëpunim me Institutin e Bankës Europiane të Investimeve (EIB) ?		vitit 2019, kane marre te gjithë masat e nevojshme ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per trashëgimine kulturore per nderhyrjet ne objektin pasuri kulturore “Muret ne Porto Romano” Durrës.		
13	12.2.2024	Lutem percjelljen e informacionit lidhur me drejtuesit e institucioneve te meposhtme kulturore (emer, mbiemer dhe adrese emaili): 1. Teatri i Operas dhe Baletit. 2. Teatri Kombetar. 3. Teatri Kombetar eksperimental. 4. Galeria e Arteve. 5. Biblioteka Kombetare. 6. Qendra Kombetare e Kultures per Femijet. 7. Arkiva Qendore e Filmit. 8. Cirku Kombetar. 9. Qendra Kombetare e Kinemase.	14.2.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		10. Muzeu Historik Kombetar. 11. Muzeu Arkeologjik Durres. 12. Muzeu i Pavaresise, Vlore. 13. Muzeu Gjergj Kastrioti, Kruje. 14. Muzeu Etnografik, Berat. 15. Muzeu Ikonografik Onufri, Berat. 16. Muzeu i Artit Mesjetar, Korce. 17. Muzeu Arkeologjik, Korce. 18. Muzeu Kombetar i Fotografise Marubi. 19. Shtepia e Gjetheve.				
14	14.2.2024	Informacion se si do të funksionojnë drejtoritë e kulturës, cilat janë njësitë që ruhen ose njësitë që shkrihen, ndryshimet që po merren në shqyrtim dhe strukturat që mund të riformatohen. Cila do të jetë hapësira e kulturës në ministrinë e re, duke nisur që nga organigrami deri te	27.3.2024	Mbështetur në vendimet nr. 30 datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, nenin 21, të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail.	Nuk ka.

		buxhetet, nismat dhe projektet, si GKA, Muzeu Kombëtar, etj.		ndryshuar, në ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore material”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të		
--	--	---	--	---	--	--

				specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17/12/2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, është propozuar projekt-struktura dhe organika e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI). Projekt struktura pasi mori miratimin e Ministrisë së		
--	--	--	--	--	--	--

				Financave dhe Departamentit të Administratës Publike u miratua me Urdhër të Kryeministri nr. 37, datë 19.02.2024. Një ndër fushat e përgjegjësisë së MEKI-t është edhe kultura. Funksioni politikbërës ka mbetur i pandryshuar dhe do të realizohet nga: - Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës; e cila është e organizuar me 3 drejtori dhe do të ketë në përbërje 6 sektorë. 1. Drejtoria e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit, Kulturës dhe Projekteve Drejtorja në përbërjen e saj është e organizuar në 2 (dy) sektorë. Konkretisht:		
--	--	--	--	---	--	--

				- Sektori i Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit dhe Kulturës, i cili në përbërje e tij ka 1 (një) përgjegjës sektori dhe 3 (tre) specialistë. - Sektori i Monitorimit dhe Menaxhimit të Projekteve në Fushën e Kulturës i cili në përbërjen e tij ka 1 (një) përgjegjës sektori dhe 3 (tre) specialist. 2. Drejtoria e Politikave për Artin dhe Kulturën Drejtoria është e organizuar në 2 (dy) sektorë. Konkreisht: - Sektori i Zhvillimit të Artit dhe Kulturës, i cili në përbërje ka 1 (një) përgjegjës sektori dhe 3 (tre) specialistë. - Sektori i Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave i cili ka 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialist.		
--	--	--	--	---	--	--

				3. Drejtoria e Politikave për Trashëgiminë Kulturore Drejtoria është e organizuar në 2 (dy) sektorë. Koncretisht: - Sektori i Trashëgimisë Materiale dhe Jomateriale, i cili ka në përbërje 1 (një) përgjegjës sektori dhe 4 (katër) specialistë. - Sektori i Muzeve dhe Njësive të Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike i cili ka në përbërje 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialist. Ju bëjmë me dije se struktura e re, ka patur shtesa në njësitë organizative sa më poshtë: Është shtuar Drejtoria e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit, Kulturës dhe Projekteve, si detyrim i		
--	--	--	--	---	--	--

				ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” Gjithashtu është shtuar Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik, Kulturës dhe Inovacionit. Institucionet e varësisë do të vijonë të funksionojnë me të njëjtin kuadër ligjor.		
15	14.2.2024	Kerkohen te dhenat ne lidhje me projektin e znj. E.H.	26.2.2024	Informacioni I kerkuar eshte vene ne dispozicion	Perfunduar. Kthim pergjigje me shkrese.	Nuk ka.
16	15.2.2024	Venie ne dispozicion te materialeve arkivore per piramiden Enver Hoxha.	23.2.2024	Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbënor” (Piramida) në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit (II-110), në qytetin e Tiranës është shpallur monument kulture kategorisë II-të nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Urdhër Nr.122 datë 05.03.2007 dhe nga Ministria e Kulturës me	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

				Urdhër Nr. 276, datë 16.07.2015. Pranë Arkivit Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) nuk disponojmë dokumentacion teknik/ skica apo projekte arkitektonike të viteve '80-të shek XX-të lidhur me objektin tuaj ne studim.		
17	16.2.2024	Kerkohen te dhenat ne lidhje me projektin e organizates -----	1.3.2024	Informacioni I kerkuar eshte vene ne dispozicion	Perfunduar. Kthim pergjigje me shkrese.	Nuk ka.
18	26.2.2024	Isha I interesuar për thirrjen që <i>Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit</i> , Insitucion në Varësi të <i>Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit</i> synon të promovojë letërsinë e re shqipe, duke u ardhur në ndihmë autorëve të rinj shqiptarë për të botuar dhe për t'u bërë pjesë e një hapësire më të gjerë njohjeje përballë lexuesit. Ajo çka jam i interesuar të di me	26.2.2024	Dokumentacioni që kërkohet është: 1. CV e autorit 2. Deklaratë për Qkll, e cila gjendet në ëëbin tonë 3. Formular, gjendet në ëëb 4. Kontrata e autorit me shtëpinë botuese 5. Llogaria Bamkare e shtëpisë botuese 6. Libri i redaktuar dhe i korrektuar Përsa i përket përkthimeve të librave mbi filozofinë, ju	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

		saktësi është kush është dokumentacioni i duhur që duhet dorëzuar i cili kërkohet brënda 05.02.2024-05.03.2024 afateve të caktuara. Dhe gjithashtu dshiroj të di nëse përkthimi i librave të lëmit filozofik mund të bëhen pjesë e këtij promovimi të letërsisë shqipe, sigurisht duke qënë brënda të gjitha rregullave të bazuara në LIGJIN Nr. 9616, datë 27.9.2006		bëjmë me dije se QKLL, hap cdo vit një thirrje për mbështetje financiare të botimeve nga shqipja në gjuhë të huaj dhe anasjelltas. Thirrja publikohet në faqet zyrtare te MEKI dhe QKLL. Për cdo informacion më të hollësishëm ju ftojme për të komunikuar në zyrat e QKLLnë cdo kohë, për t'ju sqaruar mbi mundësitë që kanë këto përkthime dhe në raport me botuesit shqiptar.		
19	26.2.2024	Sa kanë qenë të ardhurat e realizuara nga Teatri Kombëtar dhe Teatri Eksperimental për vitet 2022-2023(të ndara sipas teatrit dhe viteve)? Sa është buxheti i alokuar për Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental për vitet 2023 -2024(të ndara	29.3.2024	Te ardhurat e realizuara per vitin 2022 gjithsej perfshire dhe sponsorizimin jane ne vleren 7.655.272 leke, ku vlera e sponsorizuar eshte 3.000.0000.leke. Te ardhurat e realizuara per vitin 2023 gjithsej perfshire dhe sponsorizimin jane ne vleren 7.404.777 leke, ku vlera e sponsorizuar eshte 2.500.0000.leke.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-email.	Nuk ka.

		sipas teatrit dhe viteve)?		Bashkelidhur gjeni informacionin ne lidhje me buxhetin e Teatrit Kombetar Eksperimental "Kujtim Spahivogli".		
20	26.2.2024	Informacion ne lidhje me projektin e restaurimit te Ures se Matit.	1.3.2024	Projekti mbi ndërhyrjen emergjente në monumentin e kulturës "Ura e Matit", pritet të vendoset në zbatim nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë fitues pas pajisjes me lejen e ndërtimit nga AZHT. 2. Punimet në këtë monument kulture do të fillojnë në momentin e pajisjes me lejen e ndërtimit sikurse citohet edhe në kontratë. 3. Në lidhje me procedurën e konkurrimit publik me objekt: "Ndërhyrje emergjente në Monumentin e Kulturës "Ura e Matit"", bëjmë me dije se procedura është publikuar në	Perfunduar. Kthim pergjigje me shkrese.	Nuk ka.

				Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 101 datë 18.12.2023 (procedurë e publikuar disa herë), ku ka rezultuar e suksesshme me fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE): ---- Njoftimi i fituesit është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 103 datë 26.12.2023 dhe mes Autoritetit Kontraktor dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë është nënshkruar kontrata. 4. Në procedurën e shpallur me datë 18.12.2023 ka marrë pjesë vetëm një ofertues, përkatësisht Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë ----- të cilët janë shpallur fitues dhe Vlera e Ofertuar është 46.659.645 lekë pa tvsh.		
21	7.3.2024	1-Sa aplikime kanë mbërritur në Ministrinë	11.3.2024	Në (ish Ministria e Kulturës, sot Ministria	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

		e Kulturës nga qytetarë të Krujës për të përfituar nga Bonusi i Rijetëzimit që nga momenti që ka nisur ky projekt? 2-Sa prej numrit total të aplikimeve kanë rezultuar fitues? 3-Sa ishte numri i banesave që u restauruan me fondet e këtij bonusi për vitin 2023. Sa janë në proces? Sa janë parashikuar që do të kryen për këtë vit? 4-Na vini në dispozicion projektet e miratuara 5-Ku ndodhen banesat që janë restauruar dhe banesat që janë në proces? 6-Si ka ecur puna për restaurimin e tyre?		e Ekonomisë, Kulturës, dhe Inovacionit (MEKI)) nga qyteti Krujës kanë aplikuar për të përfituar nga Bonusi i Rijetëzimit që nga momenti që ka nisur ky projekt 4(katër) qytetarë për vitin 2022, dhe 6 (gjashtë) qytetarë për vitin 2023. Nga 4(katër) qytetarë që aplikuan për vitin 2022, kanë përfituar të katërt. Ndërsa nga 6 (gjashtë) qytetarë që aplikuan për vitin 2023, kanë përfituar vetëm 4(katër). Janë gjithsej 4 Banesa dhe janë në proces, mbyllen në vitin 2024. Projektet nuk mund t`jua vendosim në dispozicion për arsye sepse janë të projektuara nga ekspertë të fushës dhe i nënshtrohen të drejtë së autorit. Banesat që janë në restaurim në proces,	
--	--	---	--	---	--

		7-A është ndjekur procesi i restaurimit nga ekspertë të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë? Si e kanë vlerësuar ata procesin e punës? 8-A ka pasur ankesa nga ana e qytetarëve, grupeve të interesit në Krujë, të mbërritura pranë minisistrit në lidhje me cilësinë e punimeve?		janë në zonën e mbrojtur. 3 (tre) nga këto ju është kërkuar pezullim të punimeve. Proçesi i restaurimit ndiqet nga ekspertë të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë(DRTKT), në cilësinë e Supervizorit dhe mbykqyrësit të punimeve, dhe për 3(tre) nga përfituesit kanë vlerësuar në pezullim procesit të punës për shkak se nuk kanë zbatuar projektin e miratuar. Nuk ka pasur ankesa nga qytetarët.		
23	5.3.2024	Venie ne dispozicion te aktit te emerimit te znj. E.H.	18.3.2024	Dokumentacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me shkrese.	Nuk ka.
24	5.3.2024	Kopje e raportit nga UNESCO-ICOMOS për rastin e Parkut Kombëtar të Butrintit.	21.3.2024	Dokumentacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.
25	5.3.2024	Nisur nga dy marrëveshje te firmosura ne vitin 2021	11.4.2024	Informacioni ehste vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

		mes antareve te nismës Open Balkan, ne janar 2024 Shqiperia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia firmosen dy protokolle per zbatimin e marrëveshjeve per tregun e lir te punës dhe per identifikimin elektornik te qytetareve ne vendet respektive. Nisur nga kjo, lutemi te na informoni per sa me poshtë: 1. Protokolli i firmosur mes Shqiperise, Serbise dhe Maqedonise se Veriut per tregun e lire te punës, permes cilës procedure te brendshme ligjore do te miratohet per tu vene ne zbatim? 2. A do duhet te votohet protokolli i firmosur ne 22 shkurt 2024 ne Kuvendin e Shqiperise qe me pas te implementohet?				
--	--	--	--	--	--	--

		3. Ne cfare faze eshte pergatitja e faqes online per aplikimin e qytetareve per akses te lire ne tregun e punes?				
26	11.3.2024	Kerkese per informacion ne lidhje me projektet fituese per vitin 2022.	15.5.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.
27	12.3.2024	Kerkese per informacion lidhur me procedurën e prokurimit Blerje me vlerë të vogël, “Mbikëqyrja e punimeve për veprën e artit në hapësirat publike “Albanian Key””	18.3.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.
28	11.3.2024	Informacion lidhur me vendimin për mbylljen prej 4 vitesh të Muzeut Historik Kombëtar. Njoftimi u dha në faqen zyrtare të Muzeut, por që aktualisht është zhdukur; a ka ndonjë ndryshim të vendimit? Përse u hoq njoftimi nga faqja zyrtare e Muzeut? Gjithashtu kërkojmë më shumë i informacione lidhur me	29.3.2024	Mbyllja e Muzeut Historik Kombetar eshte miratuar me Urdher nr. 76 datë 23.02.2024 te Ministri te Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit "Per mbylljen e perkohshme te Muzeut Historik Kombetar". Sa i perket pyetjes suaj ne lidhje me ndonjë ndryshim te mundshem	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

		vendimin për mbylljen e Muzeut? Nga kush u mor dhe përse? Çfarë rinovimesh do të kryehen? Çfarë projekti është, sepse ende nuk është bërë publik...		te vendimit bejme me dije se nuk ka ndryshim te Vendimit. Projekti "Restaurimi, rikonstruksioni dhe muzealizimi i MHK" është një prej projekteve që financohen nga Bashkimi Europian përmes programit "EU4Culture" me Agjenci Zbatuese UNOPS Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ky projekt është hartuar dhe miratuar në mbështetje të kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve dhe është miratuar me Vendim nr. 540 datë 08.11.2023 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Projekti është pjesë e arkivit të Institutit Kombëtar të		
--	--	--	--	--	--	--

				Trashegimise Kulturore i cili administron projektet te cilat miratohen nga KKTKM. Afati 4 vjecar u mbylljes se MHK eshte ne perputhje me afatin/grafikun e punimeve ne zbatim te projektit te sipercituar.		
29	8.3.2024	Projektin final të restaurimit të Muzeut Historik Kombëtar.	26.4.2024	Ne mbeshtetje te KREU IV te ligjit nr. 119/2014 "Per te drejten e Informimit", i ndryshuar, konkretisht pika 1 e nenit 17 "E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat" si dhe bazuar ne ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to",	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

				projekti final nuk mund ti vihet ne dispozicion, ne menyre qe te mbrohen te drejtat e autorit.		
30	18.3.2024	1. Cili është autoriteti shtetëror që ushtron kontroll mbi aktivitetin tregëtar, me qëllim ruajtjen e paprekshmërisë së sitit arekeologjik? 2. A ka një raport në lidhje me aktivitetin e këtyre operatorëve ekonomik në këto site kulturore-historike? 3. Çfarë përfiton shteti nga ky aktivitet dhe a ka një kuotë që aktiviteti tregëtar i akordon si fond për mirëmbajtjen e kalasë? 4. Cila është kontrata/licenca që autoritetet shtetërore kanë nënshkruar me aktivitetin tregëtar bar restorant në këto site?	26.4.2024	MEKI e ka ezauruar kerkesen duke vene ne dispozicion informacionin qe disponon brenda fushes se pergjegjesise.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

		5. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e dokumentit I cili licencon/lejon zhvillimin e aktivitetit tregtar në sitet e sipërpërmendura nga operatorët privatë. 6. Kërkoj të më vihet në dispozicion informacion mbi pagesat/tarifat e paguara në 10 vitet e fundit nga këto operatorë për secilin sit. 7. Si garantohet paprekshmëria dhe cilat janë kushtet që duhet të plotësojë kompania që ushtron aktivitetin tregëtar?				
31	25.3.2024	1. "Projekt rikualifikimi në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë: Hartimi i projektit restaurimi i monumenteve të	3.4.2024	Informacioni është vene ne dispozicion nga DRTK Vlore.	-	Nuk ka.

		kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksion i objekteve të tjerë "Rikonstruksion i Linjës së Ujësjiellit Vlorë, Ujëra të Bardha dhe të Zeza"; 2. "Rikonstruksion/ rikualifikimi urban pranë Qendrës së qytetit Vlorë Zona B dre Justin Godart"; 3. "Rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit, Kulla e Sahatit dhe Sheshi i Flamurit", 1. Na vendosni në dispozicion projekte; 2- Na vendosni në dispozicion Trashëgimisë Kulturore Materiale, ish nga verifikimet e kryera nga an 3- A keni vërejtur parregullsi nga verifikimet tuaja, gjatë zbatimit të kët Nëse po, specifikoni për cilat raste 4-Na vendosni në dispozicion raportet që mund të jenë hartuar				
--	--	---	--	--	--	--

		nga ju ose nga ndo privat i licensuar në fushën e arkeologjisë 5- Na vendosni në dispozicion dokumentacionin, raportet dhe dokumentet e tjera që janë depozituar pranë jush apo që i dispononi për këto 3 projekte; 6- A i keni referuar shkeljet e konstatuara nëse ka pasur, vendore? Nëse po, specifikojini rastet dhe çfarë përgjigje keni marrë prej tyre 7- A janë referuar informacione pranë jush (DRTK), në lidhje me parregullsi gjatë zbatimit të kët Nëse po, si është vepruar në këto raste? 8- A keni dhënë mendime për këto projekte? Nëse po, na i vendosni në dispozicion.				
32	25.3.2024	Informacion në lidhje me projektet e realizuara në "Pedonalen e Qytetit të	16.4.2024	Kthim përgjigje nga IKTk.	Perfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka.

		Shkodrës" dhe më specifikisht tek Rrugët "28 nëntori"dhe "13 d "Gjuhadol"				
33	21.3.2024	- A ka nisur punën studio zviceriane "Oppenheim Architecture" për Muzeun Besa?- Në cilën pjesë të projektit jemi aktualisht?- Sa faza dhe sa është buxheti për këtë projekt?- A do të qëndroj e mbyllur godina këtë vit gjatë sezonit turistik?	11.4.2024	Ministria ka një kontratë me BOE "Oppenheim Architecture + Design Europe LCC", "Ralph Applebaum Associates Inc." dhe "Commonsense Studio" të lidhur me 27.10.2023 për projektimin e "Restaurimit dhe muzealizimit të ish Baneses së Toptanasve/Libohovitit , "Muzeu Besa". Konsulentet janë duke punuar për fazën e hartimit të projektit të detajuar dhe konceptit të linjes muzeore. Kontrata është e ndarë në 5 faza dhe vlera e kontratës është 20,000,000 leke (pa TVSH). Nuk parashikohet hapja e godinës për publikun deri në përfundimin e punimeve dhe hapjes	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka.

				zyrtare te Muzeut Besa. Aktualisht jemi ne fazen e hartimit te projektit. Pas finalizimit te tij dhe marrjes se gjithë miratimeve te nevojshme, do te kemi nje grafik punimesh ku mund te parashikojme finalizimin e muzeut dhe hapjen e tij per publikun.		
34	25.3.2024	Kërkohej informacion në cilësinë e trashëgimitarit të I.B lidhur me procesin e privatizimit të dy sipërfaqeve bodrum sipas dokumentacionit bashkëlidhur kësaj kërkesë.	26.3.2024	Nga verifikimi i listes se objekteve shtetërore te perfshire ne pocedure privatizimi ne qytetin e Tiranes nuk ka objekte me emertim "Bodrum". Per te marre informacion per privatizimet (shitjet) e objekteve, pronave te kryera nder vite duhet ti drejtoheni Ministrise se Financave, Drejtoria e Shitjes se Pronave Publike, pasi ajo ka rregjistrin dhe dosjet e shitjes se tyre.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail	Nuk ka.

35	26.3.2024	Kerkese per informacion ne lidhje me godinen e Teatrit te Kukullave.	16.4.2024	Zbatimi i restaurimit të godinës së Kuvendit të Parë të Shqipërisë, i njohur sot si Teatri Kombëtar i Kukullave, ka pasur një sërë vonesash që nga fillimi i restaurimit të tij. Restaurimi filloi në maj të vitit 2022 dhe zbatimi ishte menduar të zgjaste deri në maj 2023, por u zgjat dhe planifikohet të finalizohet në korrik 2024. Arsyet e vonesave janë si më poshtë: Projekti i konservimit i prodhuar fillimisht u vendos mbi hipotezën se themelet e ndërtesës ishin prej betoni. Pasi filluan punimet dhe u kryen testimet, u kuptua se ato ishin prej guri. (Testimi si i tillë nuk mund të ishte bërë në fazën e projektimit sepse ndërtesa ishte në përdorim). Kjo do të thoshte se koncepti i stabilizimit strukturor	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail	Nuk ka.
----	-----------	--	-----------	--	---------------------------------------	---------

				duhej të ribëhej tërësisht, duke përfshirë një koncept të ri të stabilizimit strukturor të mureve dhe një koncept të ri rishpërndarjeje të fibrave të karbonit për stabilizimin e kolonave. Lartësia e brendshme e auditorit, e cila është auditori i kohës së Parlamentit të Parë, nuk mund të trajtohej me fibra karboni për të parandaluar çdo humbje të autenticitetit, prandaj duheshin gjetur dhe projektuar masa shtesë stabilizimi dhe lidhjeje. Pasi dizajni u zhvillua, ai duhej t'i nënshtrohej një miratimi të ri si nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Materiale ashtu edhe nga organet e brendshme të shqyrtimit të dizajnit të UNOPS - vonesa të akumuluar deri në 8 muaj.	
--	--	--	--	--	--

				Auditori ishte projektuar fillimisht për të qenë me ndenjëse fikse. Megjithatë, në një nga vizitat në terren, ish-ministri i Kulturës kërkoi që në të njëjtën mënyrë të bëhet multifunksionale skena, edhe auditori të jetë multifunksional. Kjo kërkonte ridizajnim dhe rikonceptim të auditorit, sepse nivelet duhej të ndryshonin për të akomoduar karriget e lëvizshme dhe sipërfaqe të përshtatshme për të akomoduar një numër funksionesh, gjë që solli një vonesë prej 4 muajsh. Zgjedhja e vendeve dhe perdeve të skenës zgjati më shumë për shkak të numrit të palëve të përfshira. Kodi i ngjyrave për fasadën kërkonte një shqyrtim dhe testim të gjatë, i cili zgjati për		
--	--	--	--	--	--	--

				disa muaj derisa u gjet një kod i përshtatshëm ngjyrash që përputhej me provat historike të gjetura në vend. Situata aktuale në lidhje me të gjitha ndryshimet dhe elementët e ndryshuar gjatë zbatimit është: Zgjidhja për dyshtemenë e auditorit u miratua në mars 2024. Rishikimi i vendeve të auditorit u finalizua në prill 2024. Kodi i ngjyrave për lartësitë e brendshme dhe të gjithë elementët e tekstilit u arrit në mars 2024. Elementet në pritje të finalizimit të punimeve janë: Miratimi i kodit të ngjyrës për fasadën e jashtme (dorëzuar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore më 19 Mars - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore kërkoi që aplikimi për		
--	--	--	--	---	--	--

				kodin e ngjyrës së fasadës të dorëzohet si aplikim për leje të re konservimi për veprat e mbetura). Finalizimi i lidhjes së energjisë elektrike (në pritje). Nisur nga arsyet e mësipërme, punimet janë planifikuar të finalizohen deri në fund të korrikut.		
36	26.3.2024	Lista emërore e personave që kanë qënë pjesë e kolegjiutit të vlerësimit. 2. Shpjegim të detajuar se si është bërë procesi i vlerësimit të të gjitha projekteve dhe çfarë kanë pasur projektet fituese që nuk e kanë pasur projektet e tjera. 3. Pse janë fituese dy apo tre projekte që përmbajnë të njëjtën tematikë dhe një linjë. 4. Pse nuk janë mbështetur dhe nuk i është dhënë prioritet projekt-propozimeve nga të rinjtë për të	15.5.2024	1.Procesi i vlerësimit është bazuar ne : Udhezuesin e Thirrjes 2024, Rregulloren e funksionimit te Kolegjiutit, prioritetet e Thirrjes dhe MEKI, paraqitja e projektit sipas formatit, perputhshmeria me politikat e MEKI dhe qellimet, qendrueshmeria dhe vazhdimesia e projekteve ne realizim, shtrirja gjeografike dhe dendesia , bashkepunimet e rendesishme dhe marreveshjet,	Perfunduar. Kthim pergjijgje me e-mail.	Nuk ka.

		rinjtë. 5. Pse është shpallur fitues një projekt për një shfaqje teatrale e cila është vendosur në skenën e Teatrit Kombëtar dhe nuk është pritur mirë, por MEKI e shpall fituese. 6. Pse janë shpallur projekte fituese me edicione të dyta dhe të treta , por që nuk kanë impakt në publik prej vitesh , por bëhen vetëm për të marrë fonde. 7. Pse mungojnë kompeticionet për të rinjtë, festivale teatrore apo projekte të frymës mbështetëse për të krijuar art/teatër, projekte që nuk janë financuar në këtë drejtim. 8. Listën e renditjes të të gjitha projekteve sipas vlerësimit. 9. Shumën totale që MEKI do të financojë projektet fituese dhe sa është propabiliteti i financimi i ndonjë projekti tjetër.		permbajtja e projekt-ideve dhe cilesia e shprehjes, diversiteti i gjinive te projekt-ideve, bashkeveprimi dhe ndikimi ne turizem permes kultures, ndikimi ne edukimin e shijeve artistike permes artit dhe kultures, korrektesia ne shprehjen e kostove,m angazhimi i te rinjve ne projekt, etj, etj.qitja e projektit sipas formatit, perputhshmeria me politikat e MEKI dhe qellimet , qendrueshmeria dhe vazhdimesia e projekteve ne realizim, shtrirja gjeografike dhe dendesia , bashkepunimet e rendesishme dhe marreveshjet, permbajtja e projekt-ideve dhe cilesia e shprehjes, diversiteti i gjinive te projekt-ideve, bashkeveprimi dhe ndikimi ne turizem permes kultures,		
--	--	---	--	--	--	--

		10. Lista e projekteve fituese dhe shuma krahtyre se sa kanë kërkuar për financim.		ndikimi ne edukimin e shijeve artistike permes artit dhe kultures, korrektesia ne shprehjen e kostove,m angazhimi i te rinjve ne projekt, etj, etj. 2.Pse janë fituese dy apo tre projekte që përmbajnë të njëjtën tematikë dhe një linjë. Lutemi ne percaktimin e sakte se cilat jane keto projekte. 3.Pse nuk janë mbështetur dhe nuk i është dhënë prioritet projekt-propozimeve nga të rinjtë për të rinjtë. Lutemi konkretizimin e pyetjes. 4.Pse është shpallur fitues një projekt për një shfaqje teatrale e cila është vendosur në skenën e Teatrit Kombëtar dhe nuk është pritur mirë, por MEKI e shpall fituese. Lutemi konkretizimin e pyetjes.	
--	--	---	--	--	--

				5.Pse janë shpallur projekte fituese me edicione të dyta dhe të treta , por që nuk kanë impakt në publik prej vitesh , por bëhen vetëm për të marrë fonde. Pyetja nuk qendron, pasi vijueshmeria dhe qendrueshmeria e projekteve ne zhvillim ka qene kriter vleresues. Dhe, gjithashtu edhe per kete pyetje, glutemi te drejtoheni me konkretisht me emer projekti dhe shoqate. 6.Pse mungojnë kompeticionet për të rinjtë, festivale teatrore apo projekte të frymës mbështetëse për të krijuar art/teatër, projekte që nuk janë financuar në këtë drejtim. Kompeticionet per te rinjte nuk mungojne, duke qene se TKEKS hap thirrje per aplikime me fond dedikuar te	
--	--	--	--	--	--

				rinjve, si dhe thirrje per aplikime per projekt-ide ne fushen e teatrit. Cilat projekte konkretisht nuk jane financuar?		
37	26.3.2024	Informacion ne lidhje me disa projekte (te percaktuara nominalisht) te vitit 2023.	15.5.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjijgje me e-mail.	Nuk ka.
38	26.3.2024	Kerkese per informacion ne lidhje me zërat që mbulon Ministria per projektin tim? Dhe shifren e saktë që financohet nga Ministria ? Gjithashtu mund të më thoni ju lutem nëse pjesa e parë e financimit do të kryehet së shpejti ? Me duket se beni 80 perqind te shumes vjen para zhvillimit të aktiviteve.	27.3.2024	Informacioni eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjijgje me e-mail.	Nuk ka.
39	27.3.2024	Kur ka nisur zbatimi i projektit për restaurimin e Muzeut Etnografik të qytetit të Beratit, në lagjen	8.4.2024	“Zbatimi i projektit konservimit dhe restaurimit: “Projekt Restaurimi e Konservimi dhe	Perfunduar. Kthim pergjijgje me e-mail.	Nuk ka.

		“Mangalem”? 2- Çfarë parashikon ky projekt? Sa është vlera e tij? 3- Kur kanë nisur punimet restauruese? Kur parashikohet që të përfundojnë punimet? 4- Si po ecën zbatimi i këtij projekti? 5- Kur është bërë inspektimi i fundit në terren për zbatimin e projektit? Dhe çfarë ka rezultuar nga inspektimi i specialistëve? 6- Na vendosni në dispozicion një kopjo të projektit të miratuar.		elektrik për ndriçimin e brëndshëm dhe të jashtëm të Muzeut Etnografik të Beratit monument kulture i kategorisë së parë”: 1. Data e fillimit të punimeve në objekt është 07.02.2023 dhe data e përfundimit është 30.09.2023. 2. Ky projekt parashikon punime restaurimi, konsolidimi, restaurim çatie, restaurim dysHEMEJE, lYerje, punime shtrimi me pllaka, drenazhim, vendosje dYer dritare, restaurim tavani, punime elektrike dhe ndriçimi, etj. Vlera është 256.804,28 euro me TVSH. 3. Punimet kanë përfunduar aktualisht sipas preventivit dhe pritet të fillojë edhe zbatimi i fazës së dytë për ndriçimin. 4. Inspektimi i fundit në terren është kryer në datën 12.10.2023 dhe	
--	--	--	--	---	--

				ka rezultuar se punimet janë kryer sipas preventivit.		
40	28.3.2024	Informacion ne lidhje me projektet fituese per vitin 2024.	15.5.2024	Informacioni I disponuar nga MEKI eshte vene ne dispozicion.	Perfunduar. Kthim pergjigje me e-mail.	Nuk ka.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
